

Siguria Kombëtare dhe Llogaridhënia: Të gjesh baraspeshën e duhur

Redion Qirjazi

KLASIFIKIMI I INFORMACIONIT është një mekanizëm i rëndësishëm që përdoret nga qeveritë e shteteve të ndryshme për të mbrojtur qytetarët dhe interesat kombëtare. Megjithatë, kur regjimet e klasifikimit prodhojnë sasi tejet të mëdha informacioni sekret, ato mund të ndikojnë në qeverisjen demokratike dhe të vënë në rrezik sigurinë kombëtare. Rrjedhimisht, nga njëra anë “mbiklasifikimi” mund të çojë në ulje të mbikëqyrjes, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e sigurisë, ndërkohë që nga ana tjetër i pengon agjencitë e sigurisë të ndajnë informacione me shpejtësi dhe të zbulojnë rreziqet e sigurisë në kohën e duhur.

Po ashtu, përdorimi i tepruar i klasifikimit të informacionit si sekret mund të rrisë rreziqet e integritetit institucional, sepse mund të bëhet strehë për institucionet dhe zyrtarët publikë gjatë abuzimeve apo edhe korrupsionit. Ndonëse klasifikimi i tepruar është më i dukshëm në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, ai mund të ndodhë edhe në sektorë të tjerë publikë, veçanërisht kur shtetet dështojnë në respektimin e ligjeve për të drejtën e informimit e në krijimin e një kulture institucionale ku të qenit të hapur dhe transparentë konsiderohen si standarde për një qeverisje demokratike.

Arsyet për mbiklasifikim në Shqipëri

- **Kultura e sekretit tek agjencitë e sigurisë**
 - Shmangie e rrezikut
 - “Më mirë të sigurt sesa të ekspozuar”
- **Legjislacioni aktual vështirëson mbikëqyrjen dhe llogaridhënien**
- **Trajnim dhe monitorim i pamjaftueshëm**
 - Trajnim i kufizuar i specializuar
 - Mekanizma kontrolli të një cilësie të dobët apo që mungojnë fare
 - Probleme në mbajtjen e stafit
- **Mangësi në të kuptuarit e konceptit të rolit të institucioneve të sigurisë në demokraci (niveli strategjik)**
- **Mungesë e praktikave të deklasifikimit**

Kështu, është po aq e rëndësishme për agjencitë e sektorit të sigurisë sa edhe për institucionet e tjera publike që të zbatojnë një qasje të balancuar ndaj informacionit të klasifikuar: një qasje që siguron kompromisin e duhur mes mbrojtjes së sigurisë kombëtare ofrimit të qeverisjes së mirë duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Në kuadër të *Parimeve Botërore për Sigurinë Kombëtare dhe të Drejtën e Informimit*, të njohura edhe si Parimet Tshwane¹, u hartuan disa parime të dakordësuara përgjithësisht ku theksohet nevoja për një qasje të balancuar. Ato ndihmojnë në krijimin e kushteve që

¹ *Global Principles on National Security and the Right to Information*, “The Tshwane Principles”, 12 June 2013, <https://tinyurl.com/jzxjzkmu>

zyrtarët të hartojnë ligje dhe politika, të cilat bëjnë të mundur një kontroll dhe pjesëmarrje më të madhe të publikut në vendimmarrje, ndërkohë që sigurojnë mbrojtjen e interesave të ligjshme të sigurisë kombëtare.

Fatkeqësisht, në rastin e Shqipërisë, nevoja për të ruajtur sekretin kombëtar merr ende një vëmendje të tepruar në krahasim me të drejtën e qytetarëve për t'u informuar për vendimet që merren në emër të tyre.

Mbklasifikimi në Shqipëri

Kur trajtojmë klasifikimin e informacionit, parimi i pranuar gjerësisht është se me qëllim që të klasifikohet si sekret, informacioni duhet të jetë i një rëndësie kritike për sigurinë kombëtare. Po ashtu, në Shqipëri “sekret shtetëror” është ‘informacioni që “rrezikon sigurinë kombëtare”;² apo edhe informacioni që mund të ndikojë negativisht në “mbrojtjen e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe në marrëdhëniet me jashtë të Republikës së Shqipërisë”.³ Gjithsesi, përvoja e kohëve të fundit, siç raportohet nga burimet publike dhe institucionet e tjera të pavarura të mbikëqyrjes, tregon se klasifikimi i informacioni e ka tejkaluar qëllimin e tij në disa raste. Në fakt, tendenca për të mbipërdorur klasifikimin e informacionit ka krijuar pengesa ndaj llogaridhënies dhe transparencës së sektorit të sigurisë dhe madje edhe të agjencive qeveritare jashtë skeprit të sigurisë, të tillë si Autoriteti Rrugor Shqiptar. Të mëposhtmit janë disa shembuj që evidentojnë në gjë të tillë:

- Gjatë viteve 2014-2018, qeveria shqiptare ka rritur gradualisht çdo vit numrin e prokurimeve të klasifikuara duke arritur

shifrën 76 prokurime në vitin 2018. Gjatë viteve 2008-2014, numri i prokurimeve të klasifikuara ishte mesatarisht 5 apo 6 prokurime në vit.⁴

- Në raportin e tij për Ministrinë e Mbrojtjes, Kontrolli i Lartë i Shtetit tha se disa tendera ishin klasifikuar si “sekret” kur dukej se nuk kishte arsye ligjore për një gjë të tillë.⁵
- Në vitin 2018, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar refuzoi t'i jepte organizatës jofitimprurëse, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, një listë të gjyqtarëve dhe prokurorëve që mendohej se do t'i nënshtroheshin procesit të vetingut në Shqipëri, me pretendimin se ky informacion ishte i klasifikuar, madje edhe pas deklarimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale se ky informacion nuk klasifikohet si i tillë.⁶

Edhe pse të mësipërmit janë një numër i vogël shembujsh, klasifikimi i tepruar i informacionit në Shqipëri është mjaft i përhapur. Në fakt, të gjithë ekspertët e intervistuar të institucioneve

² Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999, “për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”

³ Po aty, neni 2

⁴ Gjergj Erebara, “Qeveria kontrakttoi miliona euro shpenzime me kontrata sekrete”, *Rrjeti BIRN*, 27 maj 2019, aksesuar nga <https://www.reporter.al/qeveria-kontrakttoi-miliona-euro-shpenzime-me-kontrata-sekrete/>

⁵ Auditi Nr. 125/5, datë 16.03.2015, *Kontrulli i Lartë i Shtetit*,

http://www.klsh.org.al/web/KLSH_kallezon_penalish_t_12_punonjes_te_Ministrise_se_Mbrojtjes_1609_1-6.php

⁶ Erida Skendaj, Fjoralba Caka, dhe Mirela Bogdani, *Rast studimor: Monitorimi i Procesit të Vettingut të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në periudhën janar 2017-qershor 2018*

http://www.osfa.al/sites/default/files/raport-studimor-monitorimi-i-procesit-te-vettingut-te-gjyqtareve-dhe-prokuroreve_jan17-qer18.pdf

(në të gjithë sektorin e sigurisë), përfshirë edhe drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të

Pse mbipërdoret klasifikimi i informacionit?

Hapi i parë shumë i rëndësishëm për t'u siguruar që klasifikimi i informacionit të bëhet ashtu siç duhet është të sigurohet që të jetë kuptuar mirë qëllimi i tij. Kjo u bën të mundur zyrtarëve të sigurisë të filtrojnë me efektivitet informacionin e parëndësishëm nga informacioni që i përket inteligjencës. Megjithatë, siç vërejnë edhe ekspertët e institucioneve, arsyeja e parë pse institucionet e mbipërdorin klasifikimin e informacionit lidhet me **“mangësitë në të kuptuarit e konceptit”** nga ana e zyrtarëve në lidhje me dallimin mes informacionit që është me rëndësi për sigurinë kombëtare dhe atij që nuk është i tillë.⁸ Si rezultat, “analistët e inteligjencës, të cilët shpesh janë konsumatorët e fundit të informacionit të klasifikuar, hasin një sasi tejet të madhe të informacionit të parëndësishëm.”⁹ Fatkeqësisht, ky proces mund të konsumojë shumë burime njerëzore dhe logjistike që angazhohen për analizimin e një informacioni të tillë, duke çuar kështu në rënie të efektivitetit të punës.

Një arsye tjetër pse institucionet priren të mbipërdorin klasifikimin e informacionit është prirja e tyre për të parandaluar rrezikun, shoqëruar me mendësinë **“nuk mund të jesh kurrë i sigurt”**. Mbipërdorimi i klasifikimit të informacionit është një problem disi i “ri” që ka lindur me fluksin e informacionit në epokën e

⁷ Intervista me mbi 10 ekspertë nga institucionet e sigurisë si Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komisioni i Sigurisë Kombëtare (Parlamenti), Ministria e Brendshme dhe ish drejtuesit në këto institucione.

⁸ Intervistë, Specialist në Sektorin e Mbledhjes dhe Analizimit të Informacionit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, 28 tetor 2020

⁹ Po aty.

Informacionit të Klasifikuar, janë në dijeni të problemit.⁷

dixhitalizimit. Nëse informacioni nuk qëmtohet dhe klasifikohet siç duhet, natyrisht që do të rritet sasia e informacionit të klasifikuar. Ashtu siç duket, institucionet e sigurisë nuk e marrin parasysh plotësisht ndikimin e sasisë së

Ndikimi i mbiklasifikimit në Shqipëri

- **Dëmton qeverisjen demokratike**
 - Ul transparencën
 - Minon mbikëqyrjen dhe llogaridhënien
 - Dëmton pozicionin politik të Shqipërisë mes vendeve të BE-së dhe NATO-s
 - Bëhet mburojë e abuzimit institucional apo të shkeljeve të integritetit
- **Prodhon mungesë efikasiteti institucional**
 - Rënie të ndarjes së informacionit për shkak të rritjes së burokracisë
 - Pengon ruajtjen e njohurive dhe menaxhimin e ndryshimit tek agjencitë e sigurisë
- **Dëmton sigurinë kombëtare – “kur çdo gjë është sekrete, informacioni vërtet sekret humbet vlerën”**

tregues i vlerës së perceptuar të institucionit për punën e tij (madje edhe në krahasim me agjencitë e tjera të sigurisë); ndaj, rreziku i mbiklasifikimit bëhet pothuajse i pashmangshëm.¹² Për më tepër, duke pasur

¹⁰ Diskutim me ish Drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, shtator 2020

¹¹ Elizabeth Goitein & Shapiro, David M., “Reducing Overclassification through Accountability”, f. 21, *Brennan Center for Justice*, 2011, aksesuar nga <https://pdfslide.net/documents/reducing-overclassification-through-accountability.html>

¹² Diskutim me zyrtar i nivelit të lartë nga Shërbimi Informativ i Shtetit, nëntor 2020

parasysh profilin tejet të politizuar të institucioneve në Shqipëri, institucionet e sigurisë priren të shmangin nxjerrjen e informacionit, që mund ta bëjë qeverinë të duket e paaftë apo edhe bashkëpunëtore në shkeljet e integritetit.¹³

Ligji aktual dhe kuadri i mëtejshëm rregullator për informacionin e klasifikuar në Shqipëri janë relativisht të vjetëruar dhe nuk janë në gjendje të rregullojnë me efektivitet aspekte që lidhen me mbipërdorimin e klasifikimit të informacioni apo me parimet e qeverisjes demokratike, si mbikëqyrja dhe llogaridhënia. P.sh., me ndryshimin e ligjit në vitin 2006 – ku pranohej fakti se institucionet e sigurisë në Shqipëri kishin probleme me “klasifikimin e ekzagjeruar” – u miratua një “nivel” i ri klasifikimi, “i kufizuar”, për të shërbyer si filtër për delegimin e informacionit, që nuk kishte rëndësi të madhe për qëllimet e sigurisë kombëtare; megjithatë, “ky nivel përdoret jashtëzakonisht rrallë, kur, në fakt, sipas analizës së ekspertit të informacionit të marrë, duhet të jetë më i përdoruri.”¹⁴

Një tjetër fushë që evidenton mangësitë e legjislacionit aktual ka të bëjë me kufizimet që i imponohen mbikëqyrjes. Këshilltari ligjor i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare argumenton se legjislacioni për informacionin e klasifikuar hartohet përmes një perspektive të “orientuar më shumë drejt sigurisë”, duke mos marrë parasysh kështu nevojën e mbikëqyrjes efektive parlamentare e duke lënë boshllëqe në lidhje me fshehtësinë, të cilat mund të shfrytëzohen për të penguar aksesin te dokumentet e klasifikuara.¹⁵ Këto pengesa kanë

çuar në tejzgjatjen e procedurave për shqyrtimin e informacionit të klasifikuar, duke vonuar kështu punën e Kuvendit ose të ndonjë organi tjetër të pavarur të mbikëqyrjes.¹⁶

Megjithatë, *e meta më e madhe* e regjimit të klasifikimit në Shqipëri mund të jenë **trajnimet, strukturat dhe proceset e pamjaftueshme** për të siguruar administrimin e duhur të informacionit të klasifikuar. Këto tre elemente janë me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për ngritjen e “një sistemi për trajtimin e informacionit të klasifikuar...sepse ndërkohë që trajnimi ofron njohuri dhe aftësi, strukturat dhe proceset ofrojnë mbështetje për zbatimin efikas.”¹⁷ Sipas zyrtarëve të lartë të inteligjencës, të kuptosh siç duhet se *cili* informacion duhet klasifikuar dhe *si* duhet klasifikuar ai është ajo që përmirëson aftësitë e personelit për të bërë dallimin mes informacionit të rëndësishëm dhe atij rutinë.¹⁸ Për më tepër, hartimi i protokolleve dhe list-kontrolleve për vlerësimin e rëndësisë së informacionit mund të forcojë saktësinë e këtij procesi vlerësimi.

Aktualisht, regjimi i klasifikimit në Shqipëri kërkon kapacitete më të mëdha për të trajnuar dhe vlerësuar në mënyrë efektive zbatimin e rregulloreve të tij. Për më tepër, ekspertët evidentojnë një sërë sfidash për praktikat aktuale të trajnimit, vlerësimit dhe administrimit të informacionit të klasifikuar:¹⁹

- Së pari, ka mungesë trajnimesh të specializuara për kërkesa të veçanta pune që çojnë në përhapjen e kulturës “të mësosh në punë” dhe “të mësosh nga

¹³ Diskutim me auditor të nivelit të lartë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, 8 tetor 2020

¹⁴ Zyrtar i lartë i Sektorit të Certifikimit të Sigurisë në Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, tetor 2020

¹⁵ Këshilltar ligjor i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, 6 nëntor 2020.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Diskutim me oficer të lartë të inteligjencës, Forcat e Armatosura

¹⁸ Opinion i përhapur mes zyrtarëve të lartë të inteligjencës të të gjitha institucionet e sigurisë (7 intervista të realizuara)

¹⁹ Diskutim me ekspertë nga shërbimet e sigurisë (oficerë të inteligjencës së ushtrisë, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar)

gabimet”. Kjo qasje çon në mungesë efikasiteti. Janë mjaft të rralla trajnimet për detyra e përgjegjësi të veçanta që lidhen me informacionin e klasifikuar. Edhe në ato raste ku kryhen, këto trajnime janë shumë të përgjithshme, duke u fokusuar kryesisht në kërkesat ligjore dhe duke ofruar fare pak udhëzime praktike që lidhen me punën e përditshme.

- Së dyti, mbajtja e stafit në sektorin e sigurisë është në nivel disi të ulët, duke shkaktuar kështu hendeqe dhe mangësi me personel të kualifikuar dhe duke i “detyruar” institucionet të nxitojnë në procesin e marrjes së miratimit të

Pështjellimet e mbipërdorimit të klasifikimit

Një e metë kryesore e mbipërdorimit të klasifikimit është se ai **dëmton qeverisjen demokratike**, sepse ai kufizon shtrirjen e mekanizmave të mbikëqyrjes, gërryen besimin e publikut tek institucionet, dhe i vendos këto të fundit përballë rreziqeve të integritetit. Auditet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) kanë nxjerrë në pah se “Ministria e Drejtësisë në periudha të caktuara bëri rezistencë ndaj disa hetimeve të veçanta nga KLSH dhe, ndonëse në fund Ministria e dha informacionin e kërkuar, ajo ngadalësoi procesin e llogaridhënies”.²⁰ Nga ana tjetër, rritja e rreziqeve të integritetit shoqërohen ngushtësisht me mbipërdorim e klasifikimit.

Mbipërdorimi i klasifikimit i jep mundësinë drejtuesve të institucioneve të *fshihen nga kontrolli publik dhe institucional* duke shfrytëzuar të drejtën e tyre me pretendimin e

²⁰ Një oficer i inteligjencës që punon në Shërbimin Informativ Shtetëror vuri në dukje se kur po bënte trajnime fillestare me diplomatët e rinj të Ministrisë së Punëve të Jashtme (në atë kohë), ai u habit me përgatitjen e dobët që kishin për temën. Megjithatë, të gjithë kishin certifikim të nivelit të lartë që do të thoshte që në një moment të caktuar ata klasifikonin ose do të klasifikonin informacionin pa e analizuar si duhet rëndësinë e tij.

certifikimit të sigurisë për personelin e sapo marrë në punë.

- Së fundi, mekanizmat e kontrollit janë të pamjaftueshëm për të siguruar që praktikat e informacionit të klasifikuar të kuptohen në nivel të pranueshëm.²⁰

Si përfundim, ashtu siç vlerëson edhe një ekspert i lartë për informacionin e klasifikuar, “mungesa e trajnimit dhe të kuptuarit çon paaftësi që sjell pasiguri dhe tendencën për të mbipërdorur klasifikimin e informacionit me qëllim shmangien e rreziqeve.”²¹

“sekretit shtetëror” për informacione të veçanta. Siç konfirmon edhe KLSH, kjo ka ndodhur në shumë raste, veçanërisht kur trajtohen prokurimet në sektorin e

Në një rast specifik, gazetarja Lindita Çela kujton se MM refuzoi t'i konfirmonte se Sekretari i Përgjithshëm i saj punonte në këtë ministri, nga frika e dëmtimit të reputacionit të tij/saj gjatë asaj periudhe.

sigurisë. Në disa raste, gazetarët e kanë pasur të vështirë të aksesojnë informacione nga Ministria e Mbrojtjes, informacione që kanë të bëjnë me tendera logjistike apo edhe me privatizimet e pronave – procedura që normalisht nuk duhej të lidheshin me informacionin e klasifikuar.²³ Në fakt, sipas gazetares investigative Lindita Çela, “refuzimi i çdo kërkesë për informacion është bërë

²¹ Intervistë, specialist në Sektorin e Analizimit dhe Mbledhjes së Informacionit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, 28 tetor 2020.

²² Erion Habilaj, auditues i sektorit të sigurisë në KLSH, diskutim në fokus grup, tetor 2020

²³ Intervistë me Lindita Çelën, gazetares investigative, 26 gusht 2020

praktikë pune në MM”.²⁴ Problem me këtë tendencë është se nëse pushteti për të refuzuar aksesin tek informacioni nuk mbahet nën kontroll, kjo mund të çojë në abuzime, që varion nga shmangia e zbulimit të keqpërdorimeve të mundshme deri te mbrojtja e reputacionit dhe/ose imazhit të zyrtarëve qeveritarë.

Për më tepër, mbipërdorimi i klasifikimit mund të dëmtojë pozicionin politik të Shqipërisë në komunitetin e gjerë të NATO-s dhe në komunitetin e vendeve që synojnë anëtarësimin në BE. Anëtarësimi në NATO ka bërë që Ministria e Mbrojtjes të marrë më shumë guxim për të justifikuar klasifikimin e tejskajshëm të informacionit si “kërkesë e NATO-s”²⁵, ndërkohë që anashkalon nevojën për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë, që janë parime shumë të rëndësishme të qeverisjes demokratike në vendet e NATO-s. Kjo është arsyeja pse disa ekspertë thonë se “MM ishte më transparente kur ishte shtet ‘Partneriteti për Paqen’ sesa tani, sepse atëherë kishte diçka për të vërtetuar.”²⁶

Së dyti, mbipërdorimi i klasifikimit mund të çojë në **burokraci të tepruar, joefikasitet dhe reduktim të ndarjes së informacionit**. Në total janë 22 agjenci sigurie që janë të autorizuar të

Klasifikimi i tepruar i informacionit mund të çojë në situatën:

1. ku informacioni shumë i rëndësishëm për sigurinë kombëtare të trajtohet me aspak seriozitet, sepse bëhet informacion “mediokër dhe humbet veçantinë e tij”, ose
2. ku institucionet do të duhet të shpenzojnë më shumë burime për të administruar siç duhet të gjithë informacionin e klasifikuar.

klasifikojnë informacione në Shqipëri. Duke qenë se natyra e burokracisë është e ndryshme në këto institucione, edhe kultura dhe metoda e trajtimit të informacionit të klasifikuar janë të ndryshme. Shumë nga këto dokumente nuk kanë nevojë të klasifikohen për qëllime të sigurisë kombëtare, por institucionet që i klasifikojnë ato, duke pasur autoritetin e plotë për të bërë një gjë të tillë, i klasifikojnë këto dokumente në të njëjtën kategori siç do të klasifikonin informacionin që lidhet me sigurinë kombëtare. Kjo sepse praktikat aktuale përcaktojnë që edhe kur klasifikohet një informacion i caktuar, në një zinxhir të gjatë dokumentesh, atëherë i gjithë zinxhiri i informacionit duhet të klasifikohet. Kjo tendencë për të konsideruar gjithçka të klasifikuar kur vetëm një pjesë e saj duhet vërtet klasifikuar, mund të lidhet drejtpërdrejt me natyrën e mbiklasifikimit tek institucionet në Shqipëri dhe sigurisht redukton ndarjen e informacionit nëpërmjet procedurave të panevojshme burokratike që krijon.²⁷

Së treti, mbipërdorimi i klasifikimit mund të **kufizojë mundësitë për transformimin institucional**. Institucionet përmirësohen përmes rivlerësimit të praktikave të tyre të brendshme dhe zhvillimit të njohurive përmes mësimave që kanë nxjerrë dhe nga përvoja. Pjesa më e madhe e informacionit të klasifikuar në Shqipëri mbetet njësoj - i klasifikuar. Me përfundimin e këtij procesi pune, ka shumë pak mundësi që ky informacion të përdoret përsëri.²⁸ Kjo praktikë e “ruajtjes” së informacionit të klasifikuar, në vend që ta vë këtë të fundit në përdorim sa më të mirë, i mohon strukturave institucionale mundësinë për të mësuar dhe për t’u zhvilluar nga një pjesë e përmbytjes së këtij informacioni. Ndonëse ka procedura për marrjen e informacionit të klasifikuar, zyrtarëve brenda institucioneve u kërkohet të kalojnë përmes një procedure të

²⁴ Po aty.

²⁵ Intervistë me zyrtarin e lartë të Drejtorisë së Planifikimit Ushtarak (J5), Kolonel, 4 nëntor 2020

²⁶ Po aty.

²⁷ Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, shtator 2020

²⁸ Intervistë me zyrtarin e lartë të inteligjencës, Forcat e Armatosura

gjatë për marrjen e tij. Procesi mund të bëjë që shumë punonjës të dekurajohen nga ky “telash”, veçanërisht kur një gjë e tillë nuk është kërkesë e pozicionit të punë, ose kur e dinë që pjesa më e madhe e këtij informacioni është thjesht informacion rutinë që ka pak vlerë për inteligjencën.²⁹

Kështu, një tjetër problem me kulturën e mbiklasifikimit është mungesa e *procedurave të deklasifikimit efikas*. Është më se e qartë se nuk vlerësohet shumë deklasifikimi i informacionit. Sipas një zyrtari të lartë të SHISH, deklasifikimi i informacionit është një koncept kaq i huaj sa që ai “nuk mbante mend se kur ishte hera e fundit që SHISH kishte deklasifikuar informacione”.³⁰ Padyshim, pamundësia për të aksesuar informacione që lidhen me sektorët e sigurisë ndikon jo vetëm në aftësinë e institucionit për të vlerësuar me sy kritik performancën e tij dhe të mësojë nga kjo, por kufizon edhe mundësinë e shoqërisë për ta studiuar dhe për të mësuar nga ky institucion.

Së katërti, **mbipërdorimi i klasifikimit mund të çojë në**

“Mungesa e trajnimit dhe të kuptuarit sjell paaftësi, e cila ushqen pasigurinë dhe tendencën për të mbipërdorur klasifikimin me qëllim shmangien e rreziqeve.”

rënie të sigurisë kombëtare, sepse kur çdo gjë klasifikohet si *shumë* e rëndësishme, si sekret shtetëror, atëherë shumë pak informacion trajtohet si i tillë. Kjo çon në aplikimin e procedurave tepër të thjeshtësuara për të gjitha nivelet e informacioneve të klasifikuara (si për informacionin që ka rëndësi për sigurinë kombëtare ashtu edhe për atë të parëndësishëm). Sipas zyrtarit të lartë të SHISH, teprimi me klasifikimin e informacionit mund të çojë në dy skenarë të mundshëm: së pari, ose informacioni shumë i rëndësishëm për sigurinë kombëtare trajtohet me aspak seriozitet, sepse bëhet informacion “mediokër dhe humbet veçantinë e tij”, ose, së dyti, institucioneve do t’u duhet të shpenzojnë më shumë kohë dhe burime për të administruar siç duhet të gjithë atë informacion ‘të klasifikuar’ dhe, duke qenë se burimet bëhen përherë e më të kufizuara, ka shumë gjasa të ndodhë skenari i parë.³¹ Prandaj, kur institucionet përballen me nevojën për të administruar sasi të mëdha informacioni të klasifikuar, ato detyrohen të angazhojnë më pak kohë dhe burime për të vlerësuar dhe vendosur me efektivitet për implikimet e këtij informacioni. Në rast të kundërt, ‘kur informacioni filtrohet me kujdes, kjo gjë bën që institucionet të klasifikojnë siç duhet informacionin dhe t’i kushtojnë atij vëmendjen e nevojshme – ndaj, ndonjëherë, me më pak bën më shumë’.³²

²⁹ Po aty.

³⁰ Diskutim me zyrtarin e lartë të inteligjencës nga Shërbimi Informativ Shtetëror, nëntor 2020

³¹ Intervistë me zyrtarin e lartë nga Shërbimi Informativ Shtetëror, nëntor 2020

³² Po aty.

Rekomandime

Ruajtja e sekretit është me rëndësi themelore për mbrojtjen e interesave kombëtare, por teprimi me informacionin e klasifikuar mund të bëjë të kundërtën e këtij qëllimi. Së pari, sepse zbeh rëndësinë e informacionit të klasifikuar që vërtet është i rëndësishëm, duke shkaktuar kështu rënie të efektivitetit të institucioneve të sigurisë; dhe së dyti, sepse pengon llogaridhënien e institucioneve të sigurisë dhe rrit rreziqet ndaj integritetit të tyre institucional. Prandaj, është me rëndësi që institucionet e sigurisë të mbeten të përgjegjshme gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre për ruajtjen e sekretit me qëllim mbrojtjen e interesit kombëtar.

Në aspektin rregullator

1. Do të ishte me përfitim si për institucionet e sigurisë ashtu edhe për publikun të **rishikohet kuadri ligjor dhe rregullator** me qëllim përmbushjen e kriterëve të sigurisë dhe llogaridhënies publike. Në mënyrë të veçantë, Ligji për Sekretin Shtetëror duhet të përfshijë edhe dispozita që mundësojnë monitorimin dhe mbikëqyrjen e papenguar të institucioneve të sigurisë në rastet kur përfshihet informacioni i klasifikuar. I duhet kushtuar më shumë vëmendje edhe mbikëqyrjes nga Kuvendi.
2. Të prezantohen mekanizma që veprojnë si **valvul “e çlirimit të presionit”** për të bërë të mundur që institucionet e sigurisë të bëjnë dallimin mes informacionit që kërkon një nivel të caktuar fshehtësie dhe atij që është thjesht rutinë e punës së përditshme të zyrtarëve. Rekomandohet që kuadri rregullator të prezantojë klauzolën “qëllim zyrtar”, me qëllim që të bëhet dallimi mes

Baraspesha mes *nevojës për ruajtjen e sekretit dhe detyrimit për llogaridhënie* duhet të jetë parimi bazë për funksionimin e aparatit të sigurisë në Shqipëri. Për të arritur një gjë të tillë, *institucionet e sigurisë duhet ta bëjnë transparencën si metodë standarde pune*, ndërkohë që klasifikimi të aplikohet vetëm në raste të kufizuara. Një qasje e tillë është në përputhje jo vetëm me standardet ndërkombëtare, si Parimet Tshwane,³³ por përcaktohet edhe në legjislacionin shqiptar për të drejtën e informimit.³⁴

Më poshtë jepen disa rekomandime për ta arritur sa më mirë këtë gjë.

këtij informacioni nga ai që ka vlerë për sigurinë kombëtare.³⁵

Praktikat institucionale

3. Të krijohet mekanizmi i **doktrinës dhe trajnimit** për regjimin e klasifikimit në Shqipëri dhe **të monitorohet** zbatimi i tij nga Autoriteti i Sigurisë Kombëtare. Për shkak të natyrës së tyre, doktrinat duhet të jenë të centralizuara në parimet e tyre bazë me qëllim që të orientojnë punën e të gjitha institucioneve në lidhje me prerogativat ligjore dhe kombëtare të sigurisë, ndërkohë që të bëjnë të mundur fleksibilitet të mjaftueshëm që çdo institucion sigurie të përshtatë metodën e tij të punës, në përputhje me karakteristikat e tyre të specifike. Doktrina duhet të ketë një qasje nga lart-poshtë në shpërndarjen e udhëzimeve dhe monitorimit, ndërkohë që të përdorë sugjerimet që vijnë nga poshtë për përmirësimin e mësimëve të nxjerra gjatë procesit të zbatimit. Ndonëse janë

³³ *Global Principles on National Security and the Right to Information*, “The Tshwane Principles”, 12 qershor 2013, <https://tinyurl.com/jzxjzkm>

³⁴ Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 17, pika 5, <https://www.drejtësia.gov.al/wp->

content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf

³⁵ Diskutim me ish Drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, shtator 2020

hartuar rregulloret, ato zbatohen pa kriter dhe monitorohen rrallë.

4. Institucionet e sigurisë duhet të ofrojnë **trajnime të vazhdueshme dhe të konsoliduara**. Regjimi i informacionit të klasifikuar në Shqipëri duhet të sigurojë *trajnime të specializuara sipas shtresave* (në bazë të nivelit të certifikimit të sigurisë) dhe të përgjithshme për të gjithë personelin që administron informacionin e klasifikuar. Institucionet kryesore që trajtojnë vazhdimisht informacione të klasifikuara (MB, MM, shërbimet e inteligjencës) duhet të krijojnë *njësi trajnimi, monitorimi, vlerësimi dhe edukimi* për të siguruar që institucioni i tyre transformohet vazhdimisht dhe përmirëson praktikën e menaxhimit të informacionit të klasifikuar. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar duhet të monitorojë qasjen e përgjithshme të këtyre njësive të trajnimit dhe të marrë sugjerimet e tyre për të përmirësuar politikën dhe rregulloret e përgjithshme për informacionin e klasifikuar.
5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar duhet të përditësojë **rregullisht trajnimet, udhëzimet dhe të kryejë operacione monitorimi** për të siguruar përmbushjen e kërkesave ligjore dhe teknike të regjimit të klasifikimit nga institucionet e sigurisë.
6. **Të ulet** numri i autoriteteve të klasifikimit fillestar sa më shumë të jetë e mundur. Aktualisht në Shqipëri janë gjithsej 22 agjenci që mund të klasifikojnë informacionin si sekret shtetëror. Kjo shpesh ka çuar në bllokime të panevojshme burokratike. Rivlerësimi i numrit të agjencive mund të ndihmojë në reduktimin e burokracisë së panevojshme dhe të ndihmojë në funksionimin e një regjimi klasifikimi që të jetë më i monitorueshëm.
7. Në kuadrin ligjor shqiptar duhet të ritrajtohen **procedurat dhe komisionet e deklasifikimit** për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Aktualisht, Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar si 'Sekret shtetëror'" ua bën tejet të vështirë punën komisioneve të deklasifikimit për shkak të përfaqësimit të nivelit të lartë dhe procedurave burokratike të përfshira në të. Institucionet e sigurisë që merren vazhdimisht me informacion të klasifikuar duhet të krijojnë komisionet e përhershme të deklasifikimit për të siguruar vazhdimësinë e gjykit, qëndrueshmërinë e praktikave dhe deklasifikim më të shpejtë të informacionit. Kjo do të jetë veçanërisht e dobishme gjatë zgjidhjes së problemeve të ngarkesës së madhe me informacion të klasifikuar, ku këto institucione kanë dështuar në trajtimin e tyre brenda afateve.

Sources

Global Principles on National Security and the Right to Information, "The Tshwane Principles", 12 June 2013, <https://tinyurl.com/jzxjzkm>

Law No. 8457, date 11.02.1999, "On information classified as 'State Secret'", article 2, commonly referred to as Law on State Secret

Law 119/2014, "On the right to information", article 17, paragraph 5, https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf

Gjergj Erebara, "Government commissions millions of euros in secret contracts", *BIRN Network*, 27 May 2019, accessed from

<https://www.reporter.al/qeveria-kontrakti-miliona-euro-shpenzime-me-kontrata-sekrete/>

Audit No. 125/5, date 16.03.2015, *Supreme State Audit Institution*,

http://www.klsh.org.al/web/KLSH_kallezon_penalisht_12_punonjes_te_Ministrise_se_Mbrojtjes_1609_1-6.php

Erida Skendaj, Fjoralba Caka, and Mirela Bogdani, *Case Study: Monitoring the vetting process of judges and prosecutors between January 2018 – June 2018*

http://www.osfa.al/sites/default/files/raport-studimor-monitorimi-i-procesit-te-vettingut-te-gjyqtareve-dhe-prokuroreve_jan17-qer18.pdf

Elizabeth Goitein & Shapiro, David M., "Reducing Overclassification through Accountability", pg. 21, *Brennan Center for Justice*, 2011, accessed from

<https://pdfslide.net/documents/reducing-overclassification-through-accountability.html>

Interviews & Discussions

Discussion with former Director of the Classified Information Security Directorate (NSA), September 2020

Interview with Director of the Classified Information Security Directorate, September 2020

Intelligence Specialist, Information Collection and Analysis Sector, *Intelligence Agency for Security and Defense*, 28 October 2020

Discussion with senior official from the State Intelligence Service, November 2020

Discussion with senior auditor of the Supreme State Audit Institution, 8 October 2020

Senior official at the Security Clearance Section, *Intelligence Agency for Security and Defense*, October 2020

Legal Counsel of the Parliamentary National Security Committee, 6 November 2020.

Discussion with senior intelligence officer, Albanian Armed Forces

Erion Habilaj, Security sector auditor at the SSAI, Focus Group discussion, October 2020

Interview with Lindita Cela, investigative journalist, 26 August 2020

Interview with senior Army Planning Directorate (J5) officer, Colonel, 04 November 2020

Interview with senior intelligence officer (J2), Albanian Armed Forces



Ky dokument politikash u përgatit në kuadrin e projektit " Siguria Kombëtare dhe Llogaridhënia: Të gjesh baraspeshën e duhur" mbështetur nga Transparency International - Mbrojtja dhe Siguria. Opinonet e shprehura në këtë artikull janë përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Transparency International.